

INVESTITORI
“TONI COMPANI” SH.P.K.



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E
PRODHIMIT TË BETONIT NGA KOMPANIA “TONI COMPANI”
SH.P.K. TALINOCI I JERLIVE - FERIZAJ

Maj - 2025

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E
 PRODHIMIT TË BETONIT NGA KOMPANIA – “TONI COMPANY” SH.P.K.
 Parcelat me numër 00374-1, 00374-2, 00370 - 1 dhe 00371-2 , Zona kadastrale Talinoci i
 Jerlive, komuna e Ferizajit**

Investitori:	“TONI COMPANY”SH.P.K.
Personi i Autorizuar:	Faton Nuredini
Adresa:	Sojevë, Ferizaj
Lokacioni:	Talinoci i Jerlive - Ferizaj
Tel:	+383 49 943 366
Email:	info@tonibeton.com

Hartuese e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	
Emri:	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Email:	Blerinabajraktari1@gmail.com Blerinabajraktari3@gmail.com
Tel:	+383 49 588 634
Nr. i Licencës:	07/20

“TONI COMPANY” SH.P.K.

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

 Nënshkrimi

 Nënshkrimi

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	5
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	6
3.	PËR KOMPANIN	7
3.1.	Vendodhja e bazës së betonit.....	7
3.3.	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	10
3.4.	Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative	11
3.5.	Lënda e pare dhe lënda ndihmëse.....	12
3.6.	Përshkrimi detal i procesit teknologjik.....	13
a)	Deponimi i Agregatit	15
b)	Bunkerët e Agregatit.....	15
c)	Përgatitja e agregatit	16
d)	Transportieri i pjerrët i agregatit.....	16
e)	Mbushja e siloseve	16
f)	Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse	17
g)	Përcaktimi i sasisë së çimentos.....	17
h)	Uji dhe rezervuarët e ujit të deponuar.....	17
i)	Rezervarët dhe pompat për aditivët e betonit	18
j)	Kompresori për ajrin e komprimuar	18
k)	Prodhimi i gatshëm (Betoni i Freskët).....	18
3.7.	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit.....	19
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E BAZËS SË PËR PRODHIMIN E BETONIT	20
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	21
5.1.	Ndotja e Ujërave.....	21
5.2.	Ndotja e Ajrit	21
5.3.	Kushtet dhe karakteristikat klimatike	22
5.4.	Lagështia relative e ajrit	23
5.5.	Karakteristikat Hidrografike.....	23
5.6.	Flora dhe Fauna	24
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	25
6.1.	Ndikimet në ajër	25
6.2.	Ndikimet në tokë	25
6.3.	Ndikimet në ujë	26
6.4.	Ndikimet në peizazh	26
6.5.	Ndikimet në Florë dhe faunë	27
6.6.	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	27

6.7 Ndikimet nga zhurma	27
6.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	28
7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	28
8. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	29
9. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS	31
9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	31
9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	31
9.3. Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë.....	32
9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma	32
9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	33
9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	33
9.7. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	33
9.8. Menaxhimi i mbeturinave.....	33
9.9. Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	34
10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	35
11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI	35
12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	37
13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE.....	38
14. LITERATURA E PERDORUR.....	39

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1. Shtirirja ku do të vendoset baza për prodhimin e betonit	7
Figura 2. Distanca e bazës për prodhimin e betonit nga komuna e Ferizajit.	8
Figura 3 Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit në raport me shtëpitë e banimit	8
Figura 4. Hapësira e bazës për prodhimin e betonit.....	10
Figura 5.Procesi teknologjik i Prodhimit të Betonit nga baza e çimentos me dy sillosa	13
Figura 6. Procesi teknologjik i prodhimit të betonit	18
Figura 7 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën 1949 – 2007.....	23
Figura 8 Rrjeti Hidrografi i Komunës së Ferizajt	24

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën 1949 – 2007.....	22
Tabela 2 Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror	34

1. HYRJE

Bazuar në Nenin 11 dhe Shtojcën 4 të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe për përmbushjen e kushteve ligjore për bazën e prodhimit të betonit nga kompania “TONI COMPANI” SH.P.K. nga Komuna e Ferizajit ka filluar përgatitjen dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për këtë aktivitet.

“TONI COMPANI” SH.P.K. është një kompani e themeluar në komunën e Ferizajit në vitin 2002 dhe do të bëjë ndërtimin e bazës së betonit në parcelat me nr. 00374-1, 00374-2, 00370 - 1 dhe 00371-2, zona kadastrale Talinoci i Jerlive, komuna e Ferizajit.

Ky raport paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për bazën e prodhimit të betonit. Ai synon të identifikojë dhe të analizojë ndikimet mjedisore të kësaj veprimtarie dhe të propozojë masa të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit në zonën e planifikuar.

Në këtë raport do të analizohen:

- Gjendja ekzistuese e mjedisit në zonën ku do të ndërtohet baza për prodhimin e betonit;
- Karakteristikat inxhinieriko-teknike të punimeve sipas projektit;
- Ndikimet mjedisore relevante, duke përfshirë edhe ndikimet kumulative në rajon;
- Masat e nevojshme për zvogëlimin e ndikimeve negative gjatë ndërtimit dhe operimit të bazës për prodhimin e betonit.

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një hap i rëndësishëm për sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe për garantimin e përputhshmërisë me standardet ligjore dhe teknike për këtë veprimtari industriale. Ndërtimi i bazës për prodhimin e betonit do të bëhet nga kompania “TONI COMPANI” SH.P.K. në zonën të cilën e ka në shfrytëzim kompania në parcelat me nr. 00374-1, 00374-2, 00370 - 1 dhe 00371-2, të zonës kadastrale Talinoci i Jerlive, komuna e Ferizajit.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Bazuar në karakteristikat e bazës për prodhimin e betonit me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas gjendjes ekzistuese (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili është bazë kryesore ligjore ku jemi referuar.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- ✚ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- ✚ Ligji për VNM Nr.08/L-181
- ✚ Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina,
- ✚ Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
- ✚ Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- ✚ Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- ✚ Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- ✚ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- ✚ Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- ✚ Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110

Udhëzimet Administrative:

- ✚ Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- ✚ Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikoj për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. PËR KOMPANIN

“Toni Compani” SH.P.K. është themeluar nga z. Gyner Nuredini në vitin 1991 (në fillim si Toni Commerce) e cila është marrë kryesisht me ndërtim të lartë. “Toni Compani” SH.P.K. është kompani që merret ekskluzivisht me prodhimin e betonit të gatshëm për përdorim dhe aktualisht ka të punësuar rreth 130 punëtorë të specializuar në prodhimin e betonit dhe operimin me makineri të rënda të teknologjisë së fundit. Kompania posedon mbi 100 automjete dhe makineri të punës me kapacitetet më të larta në vend. “Toni Compani” SH.P.K. prodhon betone të cilësisë së lartë me makineritë dhe metodat më të sofistikuar dhe më moderne, duke qenë kështu kompani lidere për prodhimin dhe furnizimin me beton në nivel të vendit dhe rajonit.

3.1. Vendodhja e bazës së betonit

Baza për prodhimin e betonit e propozuar nga kompania “TONI COMPANI” Sh.P.K. do të vendoset në zonën kadastrale Talinoci i Jerlive, Komuna e Ferizajit, në parcelat me numër 00374-1, 00374-2, 00370 - 1 dhe 00371-2. Kjo zonë është përzgjedhur për shkak të pozicionit të favorshëm gjeografik dhe qasjes së lehtë në infrastrukturën rrugore ekzistuese, duke mundësuar transport të lehtë të lëndëve të para dhe shpërndarjen efikase të betonit të prodhuar në rajonin e Ferizajit dhe më gjerë.




Figura 1. Shtrirja ku do të vendoset baza për prodhimin e betonit

Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit gjendet rreth 5 kilometra larg nga Komuna e Ferizajit. Ky pozicion ofron qasje të përshtatshme në rrugët rajonale dhe përbën një avantazh logjistik për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e produkteve përfundimtare. Zona ku parashihet ndërtimi i bazës është e klasifikuar sipas planeve

rregullative komunale si zonë e dedikuar për zhvillim ekonomik, konkretisht për veprimtari afariste, tregtare dhe industrial ku në këtë zonë gjenden edhe biznese tjera. Distanca nga vendbanimet më të afërta është rreth 235.31 metra.




Figura 2. Distanca e bazës për prodhimin e betonit nga komuna e Ferizajt.




Figura 3 Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit në raport me shtëpitë e banimit

3.2.Përshkrimi i veçorive fizike të projektit

Projekti parasheh ndërtimin dhe funksionalizimin e një baze për prodhimin e betonit në parcelat me numër 00374-1, 00374-2, 00370 - 1 dhe 00371-2 në zonën kadastrale Talinoci i Jerlive,

Komuna e Ferizajit. Baza do të përbëhet nga disa njësi funksionale të organizuara në mënyrë efikase për të përmbushur nevojat operative dhe logjistike të procesit të prodhimit të betonit.

Struktura fizike e projektit do të përfshijë:

- **Objekt administrativ**, i cili do të shërbejë për menaxhimin e përditshëm të aktivitetit të kompanisë, me hapësira për zyra, dhomë pritjeje dhe ambiente ndihmëse për staf;
- **Impianti për prodhimin e betonit (betonjerka)**, i cili do të jetë i pajisur me sistem automatik për përzierjen e agregateve, çimentos dhe ujit, duke garantuar standarde të larta të cilësisë dhe efikasitetit;
- **Silo për ruajtjen e çimentos**, të vendosura në mënyrë të sigurt dhe të pajisura me sisteme për kontrollin e pluhurit;
- **Hapësira për depozitimin e agregateve**, të ndara sipas fraksioneve, të mbuluara për të parandaluar ndotjen dhe shpërndarjen e pluhurit;
- **Zona për parkimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe makinerive ndihmëse**, përfshirë edhe hapësira për larjen dhe servisimin e tyre;
- **Infrastrukturë përcjellëse**, si rrugët e brendshme, sistemet e drenazhimit, ndriçimi dhe rrethojat mbrojtëse.

Të gjitha komponentët fizike të projektit janë të planifikuara në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore, duke synuar funksionalitet, siguri dhe ndikim minimal në ambientin përreth.




Figura 4. Hapësira e bazës për prodhimin e betonit

3.3. Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Bazat për prodhimin e betonit do të përbëhet si në vijim:

- Bunkerët Pranues të Rërës dhe Zhavorrit - (Ruajtja e materialeve të grira si rëra dhe zhavorri, që janë përbërës të rëndësishëm në përzierjen e betonit)
- Dozatorët Pneumatik - (Kontrolli i saktë i sasisë së materialeve të para që do të dërgohen në përzierës)
- Peshoret Automatike për Matjen e Materialeve - (Matja e saktë e materialeve të grira dhe çimentos për të siguruar përzierjen e duhur)
- Pompat dhe Furnizimi me Ujë - (Furnizimi i përzierësve me sasinë e nevojshme të ujit për të përzier betonin)
- Ujëmatësi për Sasinë e Matjes së Ujit - (Matja e saktë e sasive të ujit që do të përdoren në përzierje)
- Shiratat Transportues Furnizues - (Transportimi i materialeve të grira dhe çimentos nga bunkerët në mikserë ose në zona të tjera të bazës)

- Përzierësit e Betonit – Mikserët - (Përzierja e materialeve të ndryshme për të krijuar betonin e gatshëm për përdorim)
- Siloset e Çimentos me Filtraventilues - (Ruajtja e çimentos dhe mbrojtja nga ndotja dhe humbja e pluhurit)
- Transportuesit me Vidhë - (Transportimi i materialeve të ndryshme, si çimento dhe rërë, nga një pikë në tjetrën brenda bazës së prodhimit)
- Kabina Komanduese - (Menaxhimi dhe kontrolli i të gjitha operacioneve të bazës së prodhimit)
- Kompresori për Furnizim me Ajër për Pajisjet Pneumatike - (Furnizimi me ajër të kompresuar për pajisjet që përdorin teknologji pneumatike)
- Furnizimi me Energji Elektrike - (Sigurimi i energjisë elektrike për të gjitha pajisjet dhe sistemet e bazës së prodhimit)

3.4.Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative

Betoni me lëndë lidhëse inorganike paraqet në vetvete materialin prej guri artificial apo natyral, të prodhuar si rezultat i përzierjes dhe ngurtësimit të lëndëve lidhëse, çimentos, ujit, mbushësve (në këtë rast rërës dhe zhavorrit), si dhe shtesave të veçanta të marra në raporte të caktuara (aditivët). Kërkesat për një cilësi të mirë të betonit në një kohë të shkurtër ka shtyrë në industrializimin e procesit dhe për rrjedhojë krijimin e impianteve të veçanta të prodhimit. Faza operative e bazave për prodhim beton përfshin aktivitetet dhe proceset e përditshme të nevojshme për të prodhuar beton në mënyrë efikase dhe efektive. Karakteristikat e fazës operative janë:

Përbërja dhe Përzierja: Materialet kryesore janë: Çimento, agregate (rëra dhe zhavorri), ujë dhe aditivë. Saktësia në grumbullimin dhe matjen e materialeve është thelbësore për cilësinë e betonit. Përzierja e materialit ndjekja e një formule të dizajnuar për të arritur vetitë e dëshiruara të betonit, si forcën dhe qëndrueshmërinë.

Funksionimi i Pajisjeve: Pajisjet për grumbullim, mikserë, transportues dhe kamionë mikserë. Pajisjet duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të operohen në mënyrë efikase për të siguruar prodhim të qëndrueshëm.

Kontrolli i Cilësisë: Betonit i nënshtrohet teste si rrëshqitja, qëndrueshmëria në shtypje dhe punueshmëria. Monitorimi i përzierjes dhe cilësisë për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet dhe standardet

Masat e Sigurisë: Sigurimi i pajisjeve mbrojtëse personale për punëtorët. Zbatimi i procedurave të sigurisë dhe trajnime të rregullta për të minimizuar rreziqet e aksidenteve.

Pajtuëshmëria Mjedisore: Menaxhimi i mbetjeve dhe rrjedhjeve për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujit. Implementimi i masave për të reduktuar ndikimin mjedisor të procesit të prodhimit, duke ruajtur biodiversitetin dhe minimizuar ndotjen

Menaxhimi i Inventarit: Mbajtja e niveleve të çimentos, agregateve dhe furnizimeve të tjera për të shmangur mungesat ose mbingarkesat. Sigurimi i një furnizimi të vazhdueshëm për të ruajtur efikasitetin e prodhimit.

Efikasiteti i Energjisë: Implementimi i praktikave dhe pajisjeve me efikasitet energjetik për të kursyer kostot dhe për të reduktuar gjurmën e karbonit. Monitorimi dhe përmirësimi i përdorimit të energjisë për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe kostot operationale.

Mirëmbajtja dhe Riparimet: Kryerja e mirëmbajtjes së planifikuar për të mbajtur pajisjet në gjendje të mirë pune dhe për të parandaluar defektet. Trajtimi i defekteve dhe riparimet e menjëhershme për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit.

Dorëzimi i Betonit: Sigurimi i dorëzimit të betonit në kohë dhe në përputhje me kërkesat e kantierit të ndërtimit. Përdorimi i kamionëve të betonit, pompave dhe metodave të tjera për transportimin e betonit në vendin e ndërtimit.

Mbajtja e të Dhënave: Mbajtja e të dhënave të sakta për prodhimin e betonit, kontrollet e cilësisë dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Sigurimi i llogaridhënies dhe përmbushjes së kërkesave rregullatore përmes regjistrimeve dhe raportimeve të sakta.

Përmirësimi i Vazhdueshëm: Rishikimi dhe përmirësimi i proceseve të prodhimit për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot. Nxitja e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm në organizatë për të përmirësuar performancën dhe produktivitetin.

Pajtuëshmëria me Standardet: Sigurimi që betoni të plotësojë specifikimet e kërkuara për projekte të ndryshme ndërtimi. Përputhja me kodet lokale dhe rregulloret për ndërtimin dhe përdorimin e betonit.

3.5.Lënda e pare dhe lënda ndihmëse

Lëndët e para të prodhimit të betonit janë:

- Çimento,
- Agregati,
- Uji dhe
- Aditiviet here pas here

Lëndët kryesore për funksionimin e bazave për prodhimin e betonit:

- Energjia elektrike,

3.6. Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Betoni përziehet me qëllim që brumi i çimentos të veshë kokrrizat e materialit mbushës dhe të shpërndajë përbërësit e tij në një masë të njëtrajtshme. Kjo njëtrajtshmëri nuk duhet të priset, kur betoni shkarkohet nga betonierkat. Kapaciteti maksimal për prodhimin e betonit të freskët nga baza me 2 sillosa të çimentos është $\sim 125 \text{ [m}^3/\text{h]}$ dhe fillon me përgatitjen e materialeve si rëra dhe zhavorri, çimento, uji dhe aditivët (nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre). Prodhimi i betonit në betonuare fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit. Betonierat janë të tipave me përmbysje dhe me veprim të detyruar. Në rastin e betonierës “Toni Compani” SH.P.K., përzierëset-mikserët (1 copë) për bazën me 2 sillosa të çimentos janë me veprim të detyruar. Në këtë betonierë përzierja e betonit do të përcillet në kazanin e përzierëses, boshtet horizontale të së cilës rrotullohen së bashku me boshtet e lopatave përzierëse. Lëvizja relative në mes lopatave dhe betonit është e njëjtë dhe i gjithë betoni në kazan përziehet mirë. Për prodhimin e betonit të zakonshëm përdoret çimento portland dhe lloje të ndryshme të saj, si dhe lidhësit e tjerë që u përgjigjen kërkesave teknike dhe standardeve. Marka ose klasa e çimentos përcaktohet në varësi të markës apo klasës së betonit të projektuar në shtypje, në përgjithësi rezistenca e çimentos: $R_{\text{ç}} = 1$ deri 2,5 herë marka e betonit. Lloji i çimentos duhet të caktohet në varësi të rëndësisë së konstruksionit dhe kushteve të shfrytëzimit të tij, të klasës së kërkuar të betonit. Procesi teknologjik i prodhimit të betonit të freskët nga baza e çimentos me 2 sillosa ka këtë rrjedhë:




Figura 5.Procesi teknologjik i Prodhimit të Betonit nga baza e çimentos me dy sillosa

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, në impiantin me bazë të çimentos me 2 sillosa kapaciteti i të cilit do të jetë i paraparë, për 125 m³/h beton të freskët fillon me përgatitjen e materialeve si rëra dhe zhavorri, çimento, uji dhe aditivët (nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre). Kështu operacionet për bazën e prodhimit të betonit do të fillojnë nga mbushja e hinkave me rërë dhe zhavorr. Mbushja e hinkave me rërë dhe zhavorr sipas granulimeve, bëhet me anë të ngarkuesit në varshmëri nga teknologjia e markës së betonit që kërkohet të fitohet si produkt. Të gjitha deponitë e granulacioneve janë të ndara. Hapja e fortinave-bunkerëve apo shkarkimi i tyre, bëhet në mënyrë automatike në fund të cilave gjendet dozatori dhe peshorja. Hapja e fortinave të dozatorëve të caktuar, është e programuar në mënyrë automatike në varshmëri nga granulimi i agregatit që kërkohet për tipin dhe markën e betonit. Për çdo tip apo markë betoni procesi teknologjik është i programuar dhe menaxhohet në mënyrë kompjuterike. Projekti i këtij sistemi, me lëshuarje në punë të tërë linjës teknologjike mundëson plotësisht menaxhimin kompjuterik të tërë procesit teknologjik të prodhimit të betonit. Në tërësinë e impiantit për prodhimin e betonit bëjnë pjesë edhe pajimet për furnizim me ujë, pajimet pneumatike, elektrike të cilat funksionojnë si tërsi automatike. Nga fortina agregati i përcaktuar apo i zgjedhur nga receptura e kërkuar, përmes dozatorit bie në transporterin shiritor përmbledhës me peshojë, mandej në transportierin shiritor të pjerrët dhe nga aty materiali mbushës hidhët përmes hinkës në përzierëset e betonit. Përbërësit tjerë të konglomeratit për beton si çimento që vie nga siloset nëpërmjet transportereve me vidhë nga këtu hudhët në peshoren e çimentos dhe po i njëjti, në masën e caktuar sipas parametrave, përmes transportierit tjetër kërmillor hidhet në hinkën e përzierësve (mikserëve). Si operacion tjetër, që nënkupton përgatitjen, do të ishte të ushqyerit e silosit me çimenton e markës dhe tipit të paraparë. Të ushqyerit e silosit do të bëhet përmes kamionit-cisternë me ndihmën e pajisjeve pneumatike. Të ngarkuarit e siloseve gjegjësisht deponimi i çimentos bëhet me hapjen e valvualve përkatëse dhe përmes tubave, me shtytje pneumatike hudhet në brendi të siloseve. Funksioni i siloseve është i kontrolluar si mbushja dhe zbrazja përmes niveluesit me sinjalizim si dhe sistem alarmi. Mbi silosat, janë të vendosur filtrat si dhe tubat pneumatik të cilët veprojnë tek siloset. Filtrat shërbejnë për pastrimin e ajrit që del nga silosët gjatë mbushjes së tyre nga autocisterna dhe punës kontinuale të tyre për furnizimin e mikserëve (përzierësve) me çimento. Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varshmëri nga tipi i betonit dhe kushteve tjerë që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga pompa për furnizim me ujë dhe ujëmatësi, i cili bënë matjen e saktë të sasisë së ujit të nevojshëm për përfitimin e

markës së betonit. Ky do të ishte një përshkrim i shkurtër i lëvizjes së materialeve në skemën teknologjike për prodhimin e betonit. Teknologjia e prodhimit të betonit kërkon që gjatë ngarkimit të përzierësve me agregate, së pari nga fortinat lëshohet rëra me granulim më të vogël, pastaj çimento dhe më pastaj zhavorri. Se çfarë përzierje gjegjësisht konglomerati do të fitohet, mund të themi se komponentët futen në këto raporte të përafërta të dhëna në përqindje:

- agregat 78 %,
- çimento 13 % dhe
- mbetja ujë si dhe aditivët që shtohen në përmasa të caktuara.

Ndër aditivët, që jepen në varshmëri të kualitetit, është aditivi kur kemi të bëjmë me sanimin e betonit tek i cili kërkohet të shpejtuarit e kohës së ngurtësimit apo fortësisë e që në veçanti është si imperativ për prodhimin e betonit dhe implementimit të tij gjatë kohës së dimrit dhe aplikimit të tij tek konstruksionet e ndryshme të betonit. Dhënia e kësaj shtese preferohet tek rastet kur kemi të bëjmë me fabrikimin e elementeve të betonit gjatë dimrit. Në temperaturë pune të ambientit -8 °C dhe në rastet tjera kur kërkohet ngurtësimi i shpejtë, në atë mënyrë duke shpejtuar procesin kimik të hidratimit të çimentos dhe në këtë formë shpejton procesin e arritjes së fortësisë. Aditivi zakonisht jepet në ujë të përzier apo mikser, ashtu që shpërndarja e tij të jetë e njëtrajtshme. Dozimi i kësaj shtese do të jetë: 2 – 4 % të masës së çimentos (2 deri në 4 kg në 100 kg çimento), në varshmëri nga përdorimi dhe kushtet e implementimit në konstruksione.

a) Deponimi i Agregatit

Deponimi i agregatit është një hap i rëndësishëm në procesin e prodhimit të betonit, pasi kjo ndihmon në ruajtjen e cilësisë dhe efikasitetit të përzierjes. Agregati i granulateve të ndryshme sillet me kamionë ose me lugë ngarkuese deri në hapësirën për deponim të agregatit në Fabrikën e Betonit. Kamionët për transportin e agregateve janë të pajisur me karakulle ose me kasë për të ruajtur materialin në kushte të mira dhe për të parandaluar ndotjen dhe humbjen e materialit. Agregatet janë të mbuluara për të mbrojtur nga faktorët e jashtëm si reshjet e shiut ose ndotësit e tjerë gjatë transportit. Lugët ngarkuese përdoren për të ngarkuar agregatet nga vendi i grumbullimit dhe për t'i transportuar ato në hapësirën për deponim në fabrikë.

b) Bunkerët e Agregatit

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset pranues me fraksione të gurit ose rërës mbushen me anë të lugës ngarkuese nga depoja e fraksioneve të agregatit.

c) Përgatitja e agregatit

Nga bunkerët e agregatit përmes dozatorit bëhet zbrazja e agregatit përmes mbyllëseve që komandohen përmes pistonave pneumatik. Nga bunkerët e agregatit, agregati përmes transportierit horizontal mbledhës – Dozatorit bartet në Transportierin e Pjerrët Furnizues të Agregatit ku me pas agregatin e gatshëm e dorëzon në përzierësen e Betonit – Mikserit. Hapja e fortinave të dozatorëve të caktuar, është e programuar në varësi nga granulati i agregatit që kërkohet për tipin dhe markën e betonit. Për çdo tip apo markë betoni procesi teknologjik është i programuar dhe menaxhohet nga kabina komandues. Projekti i këtij sistemi, me lëshuarje në punë të tërë linjës teknologjike mundëson plotësisht menaxhimin automatik të tërë procesit teknologjik të prodhimit të betonit. Përbërësit tjerë të konglomeratit për beton si çimento që vije nga siloset e çimentos nëpërmjet transportierëve kërmillor hidhët në dozatorin e çimentos dhe po i njëjti, në masën e caktuar sipas parametrave bie në mikser volumi i të cilit është 1.5 [m³]. Agregati nga të pesë bunkerët në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro - pneumatik te cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet në siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjer në transportierin e pjerrët furnizues të agregatit - enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjer në mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit dhe nga betonjerka tjetër agregati nga të katër bunkerët në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro - pneumatik te cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet në siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjer në transportierin e pjerrët furnizues të agregatit - enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjerë në mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit.

d) Transportieri i pjerrët i agregatit

Nëpërmjet transportierit horizontal furnizues – Dozatorit respektivisht transportierit të pjerrët të agregatit, agregati i përgatitur transportohet dhe hidhet në përzierësen e betonit – Mikser.

e) Mbushja e siloseve

Mbushja e silosit (rezervuarit) të çimentos bëhet me auto-cisternë me ndihmën e pajisjeve pneumatike. Mbi siloset, janë të vendosur filtrat si dhe tubat pneumatik të cilët veprojnë tek siloset. Filtrat shërbejnë për pastrimin e ajrit nga pluhuri që del nga siloset gjatë mbushjes së tyre nga auto-cisterna dhe punës kontinuale të tyre për furnizimin e përzierëses me çimento. Të

ngarkuarit e silosit, gjegjësisht deponimi i çimentos bëhet me hapjen e valvualve përkatëse (V1, V2) dhe përmes tubave (T1, T2), me shtytje pneumatike (Sh1, Sh2) dhe hedhet në brendi të silosit. Funkcioni i mbushjes dhe zbrazjes së silosit është i kontrolluar përmes niveluesit (N1, N2) me sinjalizim si dhe sistem alarmi.

f) Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse

Transporti i çimentos nga silosat e deri në përzierësen e betonit - mikser behët përmes dy kërmilloreve. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

g) Përcaktimi i sasisë së çimentos

Përcaktimi i sasisë së çimentos bëhet me anën e peshores matëse në vartësi nga lloji i recepturës së betonit të freskët.

h) Uji dhe rezervuari i ujit

Uji për furnizim të përzierëses - mikserit do të sigurohet nga pusi nëntokësor – kompania do të hap pus nëntokësor për furnizim me ujë te bazës së prodhimit të betonit, gjithashtu kompania ka planifikuar ndertimin e një rezervuari për ruajtjen e ujit prej 10 000 [litra] në rastet kur kemi mungesë të ujit në sezonin e verës dhe po ashtu ky rezervuar do të ndikoj pozitivisht në mikser gjatë përzierjes. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3 [at] dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 3.0 [m³], zgjatja e një cikli është përafërsisht 60 [s] në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

i) Rezervarët dhe pompat për aditivët e betonit

Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varësi nga tipi i betonit dhe kushteve tjera që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.

j) Kompresori për ajrin e komprimuar

Procesi i mbylljes së dozatorëve të agregatit, dhe pajisjeve tjera përcjellëse në Fabrikën e Betonit, realizohet përmes pistonave pneumatike që furnizohen me ajër të komprimuar nga kompresori pistonik.

k) Prodhi i gatshëm (Betoni i freskët)

Prodhi i gatshëm (betoni i freskët) nëpërmjet hinkës zbrazet nga fundi i përzierës në autopërzierëset dhe me pas bartet te klienti. Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varësi nga tipi i betonit dhe kushteve tjera që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.




Figura 6. Procesi teknologjik i prodhimit të betonit

3.7. Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit

Për të përshkruar të gjitha emetimet e pritura dhe ndikimet e tjera gjatë fazës së operimit dhe të ndërtimit të bazës për prodhimin të betonit, mund të shqyrtoni disa aspekte kyçe që ndërlidhen me mjedisin dhe shoqërinë.

Në ajër: Nga ky aktivitet kemi ndotje në kufij të lejuar nga pluhuri gjatë mbushjes së bunkerëve, nga lëvizja e makinerive në sipërfaqet manipuluese si dhe në raste të përdorimit të makinerive të vjetra mund të ndodhë që lirimi i gazrave të ndikoj në ajër. Ndikime minimale në ajër, ndodhin, gjatë sjelljes së materialeve ndërtimore me kamion si dhe gjatë lëvizjes së mikserëve por janë ndikime të cilat mund të kontrollohen lehtë.

Në tokë: Duke konsideruar kapacitetet e projektuara të bazës për prodhimin e betonit, kanalet si dhe si rezultat i investimit adekuat në makineri të reja nuk do të kemi ndikime të mëdha në dhe ndërsa ujërat sipërfaqësore largohen në mënyrë të kontrolluar dhe se nuk shkarkohen në ujëra nëntokësore, ku një pjesë e tyre largohen në mënyrë natyrore ndërsa një pjesë tjetër do të trajtohet në sedimentues dhe përsëri do të merret për shfrytëzim dhe mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.

Në ujë: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së bazës të betonit nuk do të ndikoj negativisht, por duke u bazuar në masat e marrura nga kompania, nuk do të ndikoj negativisht gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit, ndotja është minimale. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për proces teknologjik të prodhimit të betonit si lëndë e parë por njëkohësisht do të përdoret edhe për pastrimin e makinerive, nevojat sanitare e higjienike të administratës si dhe ujitjen e sipërfaqeve manipuluese gjatë kohërave të thata dhe shumë të nxehta për ndalimin e ngritjes së pluhurave në ajër. Është planifikuar që ujit të merret nga pusi nëntokësor. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për nevoja teknologjike nuk shkarkohet sepse është njëra nga lëndët e para të prodhimit ndërsa nga pastrimi i makinerive do të shkarkohet në sedimentuesin për trajtimin e ujërave dhe pas trajtimit do të përdoret për pastrim të rrugëve ndërsa ujërat e shkarkuara nga punëtoret do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të qytetit. Ndikimi kryesor i ndotjes së ujërave janë shkarkimet e ujërave të pa trajtuara në mungesë të impianteve por në rastin në fjale projektuesi ka parapare trajtimin e ujërave të ndotura nga e gjithë kompania.

Zhurma: gjatë operimit mund të ketë zhurmë gjatë lëvizjes së makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjatë operimit është minimale.

Flora dhe Fauna: Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Pasi parashihet ti merr të gjithë masat në mos prishjen e florës dhe faunës.

Ndikimet sociale dhe ekonomike: Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Pasi do të ketë vende të reja të punës për banorët e rrethinës. Projekt pritet të ndikoj pozitivisht në ekonominë vendore dhe lokale të komunës së Ferizajit

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E BAZËS SË PËR PRODHIMIN E BETONIT

Për të ndërtuar bazën për prodhimin e betonit, është e rëndësishme të shqyrtohen disa alternativa të arsyeshme. Këto alternativa duhet të marrin parasysh aspektet mjedisore, teknologjike, ekonomike dhe sociale për të siguruar një zgjidhje të qëndrueshme dhe efektive. Për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit, janë shqyrtuar disa alternativa të arsyeshme për të siguruar që projekti të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm, mjedisor dhe teknologjikisht efikas. Më poshtë janë përshkruar disa alternativa të arsyeshme për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit:

- **Zhvillimi i projektit në lokacionin aktual (alternativa e përzgjedhur)**
Kjo alternativë parasheh ndërtimin e bazës në parcelat me numër 00374-1, 00374-2, 00370-1 dhe 00371-2, në zonën kadastrale Talinoci i Jerlive, Komuna e Ferizajit. Lokacioni është i përshtatshëm për shkak të distancës së arsyeshme nga zona e banuar, infrastrukturës ekzistuese rrugore, si dhe klasifikimit të zonës si hapësirë e destinuar për aktivitet industrial dhe afarist. Ky opsion konsiderohet si më optimal dhe me ndikim minimal në komponentët mjedisorë.
- **Qasje e lehtë në infrastrukturën rrugore** – Lokacioni ka dalje të drejtpërdrejtë në rrugë duke i mundësuar transport të shpejtë të betonit drejt kantierëve të ndërtimit.
- **Distanca e sigurt nga zonat e banuara** – Impianti është mjaftueshëm larg zonave të banuara për të minimizuar ndikimet negative në komunitet, si zhurma, pluhuri apo trafiku i rënduar.
- **Teren i përshtatshëm për ndërtim** – Zona ku do të vendoset impianti ka një topografi të sheshtë dhe stabilitet të mirë gjeologjik, duke shmangur nevojën për ndërhyrje të mëdha ndërtimore dhe përgatitore.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Nga analiza e gjendjes në komunën e Ferizajt të bërë nga grupet punuese sa i përket Mjedisit, u konstatua se mbrojtja e mjedisit nuk është vetëm problematike ekologjike ose teknologjike, por problematike më e thellë dhe më e gjerë që shkon drejtë dimensionit sociale, e madje edhe politik. Meqenëse mjedisi përbën pjesën integrale të zhvillimit hapësinor, parashikohet që ai të planifikohet e jo vetëm që të merremi me eliminimin e pasojave në këtë drejtim, por ekipet kanë parapare mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshirë krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin. Për këtë arsye, janë paraparë hapësirat e deponive në nivel vendbanimi, dhe nivel komunale. Janë parapare masa edhe për amortizim të efekteve dhe mbrojtje nga ndotësit dhe kërcënuesit e tjerë mjedisor, si dhe masa për zhvillim kualitativ mjedisor.

5.1.Ndotja e Ujërave

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese, sa i përket cilësisë, resurseve dhe burimeve ujore, është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Parashikohet edhe zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve të ujit për plotësimin e nevojave për të sotmen dhe për të ardhmen.

5.2.Ndotja e Ajrit

Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Ferizajt adreson problemet ajrit në aspektin e ndotjes dhe cilësisë së tij. Prania e komunikacionit hekurudhor e autostradës “Arbën Xhaferi” dhe magjistraleve Prishtinë – Shkup, Gjilan – Ferizaj dhe Ferizaj - Shtime në këtë komunë është një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshëm të gazrave në atmosferë, si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga komunikacioni. Ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2024 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Grimcat e imëta PM₁₀ (të ngurta, të lëngshme ose gaz) mund të depërtojnë në mushkëri duke shkaktuar efekte të mëdha shëndetësore të tilla si sulmet në zemër, kanceri në mushkëri, bronkitin kronik dhe ndikim më seriozi ka tek të moshuarit, fëmijët dhe diabetikët. Efekte të vogla shëndetësore përfshijnë. Këto efekte shëndetësore ndikojnë në cilësinë e jetesës

çdokujt dhe ndërhyjnë në mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të banorëve të komunës së Ferizajt. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së semundshmërisë me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike 210 që sjell ndotja e ajrit për Komunën e Ferizajt.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit, e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse, cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Institucioni për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës (IHMK). Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr. 08 / L-025; dhe LIGJI NR. 06/L-035 PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE, IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës. Në territorin e komunës së Ferizajt nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhet të vendosen instrumente monitoruese në disa pika me të frekuentuara nga makinat. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit e pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes.

5.3.Kushtet dhe karakteristikat klimatike

Temperatura mesatare vjetore në Komuna e Ferizajt është 10 gradë celsius, gjersa 9gradë celsius në viset malore. Muajt më të nxehtë janë Korriku dhe Gushti më temperature mesatare 20,6 dhe 20,5 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është janari më –1,4 gradë celsius. Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është në Gusht 37,3 gradë celsius, ndërsa minimumi –26,0 gradë celsius. Sipas të dhënave të IHMK. Në vitin 1963 në Ferizaj është regjistruar temperatura maksimale ekstreme -34.0 gradë celsius.

Tabela 1 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën 1949 – 2007

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	-1.2	0.9	5.7	9.9	14.6	17.9	19.9	19.8	16.0	10.5	5.3	0.9	10.0




Figura 7 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën 1949 – 2007

5.4. Lagështia relative e ajrit

Ka vlerë mesatare vjetore 74,7% më muajin gusht më të thatë (63%) dhe me muajin më lagështi më të madhe janarin (86,1%). Sipas të dhënave të IHMK. Lagështia më e lartë mesatare sillet prej 85.0 % deri 87.0 %, në muajt Dhjetor dhe Janar, ndërsa ajo më e ultë në muajt Prill dhe Maj, e cila sillet prej 68.2 % deri 68.4 %. Kohë me vranësi më të lartë ka janari me 7.3/10, ndërsa vranësi më të ultë ka gushti me 3.8/10.

5.5. Karakteristikat Hidrografike

Rajoni përreth Ferizajt merret si mbarimi i Rrafshit të Kosovës dhe lidhja e saj hapësinore me Anamoravën. Ky rajon kufizohet me Malin e Sharrit në jugperëndim, me Karadakun dhe Anamoravën në lindje, dhe me Malet e Drenicës në veriperëndim. Nëpër territorin e Komunës rrjedhin lumenj dhe përrenj të shumtë. Lumi kryesor është ai i Nerodimes, i cili kalon edhe nëpër qytetin e Ferizajt. Ky lum është i mbuluar brenda qytetit. Hidrografinë e këtij lumi e përbëjnë 13 përrenj. Lartësia mbidetare e lumit në Ferizaj është 580m. Komuna e Ferizajt ka ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ujërat sipërfaqësore Ujërat sipërfaqësore rrjedhin përgjatë lumit Nerodime, i cila është degë e rëndësishme e Lumit Lepenc. Lumi Nerodime përbëhet prej dy lumenjve, Lumi i Madh dhe Lumi i Vogël, që burojnë në rrëzën jugore të malit të Nerodimës, në lartësi mbidetare prej 1200m është 0.9m³/sec. Gjatësia e rrjedhës së lumit Nerodime është 29 km, sipërfaqja e pellgut 255km², ndërsa sasia mesatare . Lumi Nerodime është rrjedhë e dobët për shkak të bigëzimit – bifurkimit, fenomen i rëndësishëm gjeografik, i njohur edhe në botën e jashtme. Bifurkacioni gjendet 1 km në veri-përëndim të Ferizajt, mbi dhe nën vendin e quajtur të Mulliri i Nikës. Si fenomen natyror është i njohur që nga viti 1321. Ujërat tjerë sipërfaqësor në territorin e Komunës së Ferizajt, janë në shfrytëzim për ujitjen e tokës, lumi i Pleshinës dhe i Gremës, që bashkohen me lumin Nerodime të fshati Gurëz (dega

të trashëgimisë natyrore si: Bifurkacioni i lumit Neredime, ndërtimet e shtëpive, ndërhyrjet (ngushtimet) në shtretërit e dy degëve të lumit, derdhja e ujërave të ndotura etj.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të ndikimeve në mjedis përfaqëson një komponent kyç në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), me qëllim të parashikimit të efekteve që mund të shkaktojë projekti në mjedisin natyror dhe social, si dhe për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të informuara. Projekti për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit përfshin aktivitete që mund të ndikojnë në komponentë të ndryshëm mjedisor, përfshirë cilësinë e ajrit dhe ujit, tokën, biodiversitetin, klimën akustike, peizazhin, si dhe mirëqenien e komunitetit lokal. Këto ndikime mund të ndodhin si gjatë fazës së ndërtimit, ashtu edhe gjatë operimit të bazës, dhe ato mund të jenë të përkohshme ose afatgjata, të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Në këtë kapitull do të paraqiten dhe analizohen të gjitha ndikimet e mundshme në mjedis, duke u mbështetur në karakteristikat teknike të projektit, vendndodhjen, llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen, si dhe në përvojat e ngjashme të aplikimit të kësaj teknologjie në sektorin industrial. Për çdo komponent mjedisor do të identifikohen ndikimet e mundshme, shkalla e tyre, kohëzgjatja, si dhe masat parandaluese dhe zbutëse që parashihen për të minimizuar efektet negative dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm.

6.1. Ndikimet në ajër

Ndikimet në ajër gjatë ndërtimit dhe operimit të bazës për prodhimin e betonit mund të ndodhin si pasojë e aktiviteteve të ndryshme që janë të lidhura me procesin e prodhimit, transportit dhe ruajtjes së materialeve. Gjatë fazës së ndërtimit, aktivitetet si pastrimi i terrenit, transporti i materialeve dhe përdorimi i makinerive të rënda mund të shkaktojnë krijimin dhe shpërndarjen e pluhurit. Përdorimi i makinerive të rënda, si ekskavatorë, kamionë dhe makineri për ndërtim mund të shkaktojë emetimin e gazrave të dëmshëm si CO₂, NO_x dhe grimca të tjera nga djegia e karburanteve fosile. Proceset e prodhimit, transportit dhe ruajtjes së lëndëve të para (si agregatet dhe çimentoja) mund të krijojnë pluhur që shpërndahet në ajër. Aktivitetet si ngarkimi, shkarkimi dhe ruajtja e materialeve mund të jenë burime të pluhurit. Proceset industriale dhe transporti i lëndëve të para mund të çojnë në emetimin e gazrave si dioksidi i karbonit (CO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe oksidet e squfurit (SO₂).

6.2. Ndikimet në tokë

Ndikimet në tokë gjatë ndërtimit dhe operimit të bazës për prodhimin e betonit mund të ndodhin për shkak të aktiviteteve të ndryshme që janë pjesë e këtij procesi. Gjatë fazës së ndërtimit, përdorimi i makinerive të rënda dhe largimi i shtresës së sipërme të tokës mund të çojnë në

degradimin e saj. Gjatë ndërtimit, mund të ndodhin derdhje të vajra këto substanca mund të depërtojnë në tokë dhe të shkaktojnë ndotje të saj, duke rrezikuar cilësinë e ujërave nëntokësore dhe burimet e ujit të pijshëm. Gjatë operimit të bazës për prodhimin e betonit prodhimi i betonit mund të krijojë mbeturina të ndryshme, përfshirë mbeturina organike dhe jo organike. Këto mbeturina mund të deponohen në tokë dhe, nëse nuk trajtohen siç duhet, mund të kontaminojnë mjedisin. Aktivitetet e transportit të materialeve dhe përdorimi i makinerive të rënda mund të çojnë në shtimin e erozionit të tokës. Kjo mund të ndodhë për shkak të shkatërrimit të shtresës mbrojtëse të tokës dhe zvogëlimit të stabilitetit të saj. Zonat ku ruhen materialet e përdorura për prodhimin e betonit mund të ndikojnë në tokë për shkak të kompresionit të saj nga ngarkesat e materialeve të rënda, që mund të shkaktojë shtypje dhe deformime të tokës, duke ndikuar në aftësinë e saj për të ruajtur ujë dhe për të mbajtur vegjetacionin.

6.3 Ndikimet në ujë

Ndërtimi dhe funksionimi i bazës për prodhimin e betonit mund të shkaktojë ndikime të ndryshme në burimet ujore, si për sa i përket sasisë ashtu edhe cilësisë së ujit në mjedis. Këto ndikime varen nga menaxhimi i ujërave teknologjike, atmosferike dhe atyre të ndotura që gjenerohen gjatë proceseve të prodhimit. Rrjedhjet sipërfaqësore të ujit gjatë reshjeve, të cilat mund të përmbajnë sedimente dhe ndotës si pluhur, vajra apo substanca të tjera nga makineritë ndërtimore. Shpërndarja jo e kontrolluar e materialeve ndërtimore që mund të përfundojnë në trupat ujorë të afërt ose në rrjetin e kanalizimit. Në fazën e operimit, ndikimet në ujë mund të paraqiten si rezultat i derdhjeve të ujërave të ndotura që përmbajnë mbetje të çimentos apo aggregateve, shpëlarjes së automjeteve apo pajisjeve që nuk realizohet në mënyrë të kontrolluar;

6.4 Ndikimet në peizazh

Ndërtimi i bazës për prodhimin e betonit përbën një ndërhyrje fizike në mjedis që mund të ndikojë në karakterin vizual dhe estetik të zonës përreth. Ndikimi në peizazh vlerësohet në raport me morfologjinë ekzistuese të territorit, lartësinë e ndërtesave, strukturën e objekteve ndihmëse dhe praninë e elementeve industrialë që ndryshojnë pamjen natyrore ose rurale të hapësirës. Zona ku do të vendoset baza për prodhimin e betonit është e kategorizuar si zonë me destinim ekonomik-industrial, ku tashmë janë të pranishme edhe biznese të tjera të ngjashme. Për rrjedhojë, ndërhyrja e propozuar është në harmoni me zhvillimet ekzistuese dhe nuk përbën devijim të madh nga peizazhi aktual. Megjithatë, ngritja e strukturave teknologjike, makinerive të mëdha dhe zonave të depozitimit të materialeve ndërtimore mund të ndikojë në integritetin vizual të zonës, sidomos kur shihet nga distanca apo nga rrugët përreth.

6.5. Ndikimet në Florë dhe faunë

Zhvillimi i projektit për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Talinoci i Jerlive, komunë e Ferizajit, mund të ndikojë në florën dhe faunën lokale, veçanërisht gjatë fazës së ndërtimit dhe në periudhën e hershme të operimit. Zona ku do të realizohet projekti është e kategorizuar si zonë me destinim ekonomik dhe industrial, dhe nuk përfshin habitate natyrore të mbrojtura apo sipërfaqe me rëndësi të lartë ekologjike. Si e tillë, biodiversiteti i kësaj zone tashmë është i kufizuar për shkak të ndërhyrjeve të mëhershme njerëzore dhe prezencës së aktiviteteve ekonomike.

6.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Gjatë ndërtimit të bazës të prodhimit të betonit si dhe nga zhvillimi i aktivitetit të bazës së betonit, për shkak të pozitës dhe largësisë nga vendbanimet si që e kemi cekur në pjesët e më sipërme, nuk do të ketë nevojë të bëhet ç ‘vendosja e asnjë ndërtese banuese e as ndërtesave tjera ndihmëse. Prandaj si u cek më lartë në aspektin social do të ketë ndikime pozitive.

6.7 Ndikimet nga zhurma

Funksionimi i makinerive të rënda, dërmuesve dhe pajisjeve të përfshira në prodhimin e betonit mund të gjenerojnë nivele të larta zhurmës. Kjo zhurmë mund të prishë paqen dhe qetësinë e komuniteteve përreth, duke ndikuar në cilësinë e jetës së banorëve, modelet e gjumit dhe mirëqenien e përgjithshme. Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të caktuara me ligje dhe rregulla të aplikueshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Niveli i zhurmës për zonat e banuara në bazë të standardeve ndërkombëtare është i caktuar 50 dB për kohën gjatë ditës, kurse gjatë natës niveli i zhurmës duhet të jetë max. 45 dB. Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Tabela 1. Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës

Zhurma	Distanca e lejuar (metra)			
	10	50	100	500
90db – Niveli i pajisjeve modele	59	45	39	25

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin prodhues të pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, si dhe duke pasur parasysh se punohet vetëm ditën, mund të konkludojmë se baza për prodhimin e betonit nuk ka ndikime negative.

6.8.Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i bazës për prodhimin e betonit dhe pajisjeve tjera përcjellëse janë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe njëherë kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese.
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes).
- Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentos dhe betonit.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë kyçës së automjeteve transportues nga baza e betonit në rrugën regjionale.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundeshe që mund të ndodhin me operimin e bazës të prodhimit të Betonit nga kompania “Toni Compani”SH.P.K. janë:

Ndikimet në Ajër: Prodhimi i betonit shpesh krijon pluhur, veçanërisht gjatë përzierjes dhe transportit të materialeve si çimento, aggregate, dhe aditivë. Ky pluhur mund të përmbajë grimca të imta që ndotin ajrin.

Ndikimet në Tokë: Aktivitetet e ndërtimit, përfshirë përdorimin e makinerive të rënda, mund të shkaktojnë ngjeshjen e tokës, e cila ndikon në aftësinë e saj për të mbajtur ujë dhe për të mbështetur rritjen e bimëve.

Ndikimet në Ujërat Nëntokësore dhe Sipërfaqësorë: Shkarkimet e ujërave të përdorura gjatë procesit të prodhimit mund të ndotin burimet e ujit nëntokësorë dhe sipërfaqësorë.

Ndikimet në Peizazh dhe Ekosisteme: Aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë peizazhin natyror dhe të ndikojnë në pamjen vizuale të zonës, ndërhyrjet në habitatet natyrore mund të ndikojnë në florën dhe faunën lokale, duke ndikuar në biodiversitetin e zonës.

Ndikimet në Vendbanime dhe Popullatë: Aktivitetet e ndërtimit dhe operacionet bazës për prodhimin e betonit mund të krijojnë zhurmë dhe ndotje që ndikon në cilësinë e jetesës për banorët e zonës.

Betonjerka “Toni Compani”SH.P.K. , si çdo bazë tjetër e prodhimit të betonit, mund të ketë ndikime të shumta në mjedis, duke prekur ajrin, tokën, ujërat, peizazhin dhe vendbanimet përreth. Për të menaxhuar këto ndikime dhe për të minimizuar efektet negative, është e rëndësishme të zbatohet një qasje e qëndrueshme që përfshin monitorimin e vazhdueshëm, implementimin e masave të zbutjes dhe angazhimin e komunitetit për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të mbrojtur ambientin dhe shëndetin publik.

8. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë informatë dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhies së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhies së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS

Zbatimi i projektit për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit shoqërohet me një sërë ndikimesh të mundshme në komponentët mjedisorë, si ajri, toka, uji, peizazhi, si dhe në shëndetin dhe mirëqenien e popullatës përreth. Për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të këtij projekti dhe për të mbrojtur integritetin ekologjik dhe shoqëror të zonës, është e domosdoshme të identifikohen dhe të zbatohen masa efektive për parandalimin, reduktimin dhe, kur është e mundur, eliminimin e këtyre ndikimeve. Këto masa synojnë të sigurojnë që ndërhyrjet e planifikuara të jenë sa më të përshtatshme për mjedisin, të përputhen me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe të ruajnë ekuilibrin midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së natyrës dhe komunitetit lokal. Ato përfshijnë masa teknike, organizative dhe monitoruese, që zbatohen në faza të ndryshme të ciklit të jetës së projektit: ndërtim, operim dhe mbyllje të mundshme. Në vijim paraqiten masat konkrete të propozuara për minimizimin e ndikimeve negative mjedisore, të ndara sipas fushëveprimit të tyre dhe komponentëve të prekur.

9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të mbrojtur cilësinë e ajrit dhe për të zvogëluar ndotjen në bazën për prodhimin e betonit, është thelbësore të implementohen një sërë masash dhe praktikash më të mira. Aplikimi i sistemeve të spërkatjes së ujit është një metodë efektive për shtypjen e pluhurit që ngrihet në ajër gjatë operacioneve të prodhimit. Ruajtja e lëndëve të para në zona të mbyllura ose të mbuluara ndihmon në parandalimin e shpërndarjes së pluhurit nga era. Përdorimi i transportuesve ose kanaleve të mbyllura gjatë transferimit të materialeve mund të zvogëlojë rrezikun e derdhjes dhe shpërndarjes së pluhurit. Për të siguruar efikasitetin e masave të kontrollit të pluhurit, është e domosdoshme të bëhet inspektimi dhe pastrimi i rregullt i filtrave dhe mediave filtruesve në sistemet e grumbullimit të pluhurit. Gjithashtu, është thelbësore që kamionët dhe automjetet që përdoren për transportimin e materialeve dhe betonit të jenë të mirëmbajtur dhe të përmbushin standardet e emetimeve, për të siguruar që ato të mos kontribuojnë në ndotjen e ajrit gjatë operacioneve të transportit.

9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të reduktuar ndikimet negative të bazës së prodhimit të betonit në ujë, janë të nevojshme disa masa efektive. Këto masa ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e mjedisit. Monitorim dhe kontrollimi i përmbajtjeve dhe shkarkimet në ujëra për të siguruar se ato përmbushin standardet dhe rregullat e ndotjes. Kryerja e studimeve të rregullta për të vlerësuar

ndikimin e aktiviteteve të prodhimit në ujë dhe për të rekomanduar masa të nevojshme. Implementimi i masave për të ndaluar shkarkimet aksidentale nga sistemet e ndihmës që mund të ndodhin për shkak të defekteve në pajisje ose procese. Zhvillimi i sistemeve të drenazhimit për të kontrolluar rrjedhjen e ujërave sipërfaqësore dhe për të reduktuar erozionin dhe ndotjen e ujërave. Mirëpo kompani do të ndërtoj sedimentuesin për trajtimin e ujërave dhe në bazë të masave që i ka marrë kompania nuk ka ndikim në ujë për shkak që shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për nevoja teknologjike nuk shkarkohet sepse është njëra nga lëndët e para të prodhimit ndërsa nga pastrimi i makinerive do të shkarkohet në sedimentuesin për trajtimin e ujërave dhe pas trajtimit do të përdoret për pastrim të rrugëve ndërsa ujërat e shkarkuara nga punëtoret do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

9.3.Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë

Për të zvogëluar ndikimet negative në tokë nga baza e prodhimit të betonit, është e rëndësishme të zbatohen një sërë masash dhe praktikash të menaxhimit të mjedisit. Zbatimi i praktikave për të mbrojtur tokën nga erozioni, si mbulimi i sipërfaqeve të zbuluara me materiale mbrojtëse ose mbulime vegjetative për të parandaluar rrjedhjen e ujit. Përdorni teknikë të avancuara dhe makineri që minimizojnë ngjeshjen e tokës dhe ndikimet në strukturën e saj. Implementimi një sistem të efektshëm për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë riciklimin e materialeve dhe trajtimin e mbetjeve të ndotura për të parandaluar ndotjen e tokës. Siguroni që materialet dhe pajisjet të ruhen në mënyrë që të parandaloni ndotjen e tokës nga derdhjet aksidentale. Ruani dhe mbani vegjetacionin ekzistues sa më shumë që të jetë e mundur për të ndihmuar në parandalimin e erozionit dhe për të mbajtur stabilitetin e tokës. Kryeni pastrim të rregullt të tokës për të hequr mbeturinat dhe ndotësit e mundshëm që mund të ndikojnë në cilësinë e tokës dhe shëndetin e ekosistemeve.

9.4.Masat për mbrojtje nga zhurma

Të bëhet matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

9.5.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Prodhimi i betonit mund të ketë ndikime të rëndësishme në florë dhe faunë. Për të zbutur këto ndikime, është thelbësore të zbatohen një sërë masash dhe praktikash më të mira. Me zbatimin e masave të ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës mund të kemi një flore dhe faune të mirë në afërsi të bazës së prodhimit të betonit. Sa i përket peizazhit do të ndryshoj sepse do të ndërtohet baza me të gjitha elementet e sajë por duhet mbjelle drunjtë dhe pisha për arsye të përmirësimit të ambientit dhe natyrës.

9.6.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Baza për prodhimin e betonit mund të kenë ndikime të rëndësishme në vendbanimet dhe popullatat, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe zhurmës, bllokimin e trafikut dhe shqetësime të tjera mjedisore dhe sociale. Për të ruajtur popullatën dhe vendbanimet kompania do ti ndërmarr të gjitha masat për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, zhurmës që të mos ndikojnë negativisht në popullatë edhe pse nuk ka shtëpi afër po ashtu do të ketë dhe ndikime pozitive për arsyeje që me fillimin e punës do krijohen dhe shumë vende pune për popullatën e asaj rrethine.

9.7.Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Për mbrojtjen ndaj rreziqeve dhe aksidenteve mjedisore duhet marrur masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale. Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve mjedisore. Duhet të bëhet plani për mbrojtje nga zjarri. Duhet pjesa e oborrit të betonierkes të thuret me tel gjembor. Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera. Të merren të gjitha masat e sigurisë për kycjen e automjeteve transportuese në rrugën lokale dhe atë magjistrale pa penguar komunikacionin. Të merren të gjitha masat e sigurisë komfor ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

9.8. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë ndërtimit dhe operimit të bazës për prodhimin e betonit, janë vetëm mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës në bazat e betonit. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave kompania i dërgon tek kompanitë për menaxhimin e mbeturinave nga Komuna e Ferizajit.

Tabela 2 Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e Rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për Deponim të mbeturinave
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Për mbetje e mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do të trajtohen komfor legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.

9.9.Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial të vogla për ndotjen e kualiteti të ajrit.	Transporti, ngarkimi/shkarkimi i materialeve ndërtimore dhe prodhimi i betonit	- Spërkatja me ujë e sipërfaqeve pluhurosëse - Mbulesa për ngarkesa gjatë transportit - Mirëmbajtja e mjeteve për të reduktuar emetimet
Uji dhe Toka	Potencial minimal	Derdhja e mundshme e betonit ose vajrave në tokë. Depozitimi i mbetjeve, rrjedhjet nga mjetet dhe makineritë	- Sistemi për grumbullimin e ujërave të ndotura - Ndarja dhe depozitimi i mbetjeve sipas kategorive - Parandalimi i derdhjeve me sistem ndalues dhe mirëmbajtje - Rikultivimi i tokës pas përfundimit të punimeve
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e	Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në zhdukje.	Zhurma, ndotja, ndërhyrjet fizike në mjedisin natyror	- Monitorim sezonal i florës dhe faunës për ndikime - Rivendosja e gjendjes natyrore pas ndërtimit

mbrojtura të natyrës)			
Zhurma	Potencial minimal	Aktivitetet ndërtimore, lëvizja e makinerive, aktivitetet e transportit	Zbatimi i orarit të punës për aktivitetet ndërtimore, përdorimi i pajisjeve me zhurmë të kontrolluar dhe mundësia e zëvendësimit të makinerive më të qeta.
Shëndeti i qytetareve	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës se bazës së betonit.	Te gjitha pajisjet te cilat mund te kenë ndikime ne shëndetin e qytetareve do tu kushtohet rëndësi e veçan ne mirëmbajtjen e tyre.

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me Bazën për prodhimin e Betonit nga kompania “Toni Compani” SH.P.K., nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit dhe hidrantë të brendshme për fikjen e zjarrit.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi – Monitorimi dhe raportimi janë aspekte thelbësore të menaxhimit mjedisor për ndërtimin dhe operimin e bazës për prodhimin e betonit. Këto procese ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë me rregulloret mjedisore, në vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mjedisore. Më poshtë është një përshkrim i metodave dhe praktikave për monitorimin dhe raportimin mjedisor.

Monitorimi i Ajrit

- **Monitorimi i Cilësisë së Ajrit:** Ky monitorim do të kryhet nga kompania e licencuar për matje të emisioneve në ajër.
- **Matja e Emetimeve nga Pajisjet dhe Makineritë:** Monitorimi i emetimeve nga makineritë dhe pajisjet që përdoren gjatë ndërtimit dhe operimit të bazës për prodhimin e betonit.

Monitorimi i Zhurmës

- **Matja e Nivelit të Zhurmës:** Përdorimi i pajisjeve për matjen e niveleve të zhurmës në dhe përreth bazës për prodhimin e betonit për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe për të minimizuar shqetësimet për banorët lokalë.
- **Rishikimi Periodik:** Rishikimi i rregullt i politikave dhe procedurave mjedisore për të siguruar që ato janë të azhuruara dhe përputhen me praktikatat më të mira dhe kërkesat rregullatore.

Monitorimi dhe raportimi i pasojave mjedisore nga ndërtimi dhe operimi e bazës për prodhimin e betonit, janë thelbësore për të siguruar që ndikimet negative të minimizohen dhe që impianti të operojë në përputhje me standardet dhe rregulloret mjedisore. Kjo kërkon një qasje të integruar që përfshin vendosjen e sistemeve të monitorimit, përgatitjen e raporteve të detajuara, vlerësimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e praktikave mjedisore.

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë sajë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara mund të arrijmë në një përfundim si në vijim: Baza për prodhimin e betonit nga kompania “Toni Compani” SH.P.K., ka për qëllim prodhimin e betonit të freskët si dhe furnizimin e shpejte dhe në kohë, për nevojat e kompanisë si dhe për nevojat e qytetareve në rajonin e komunës së Ferizajit dhe me gjerë, e që është në interes;

- Të vet investitorit për të përmirësuar kushtet dhe efikasitetin e punës,
- Në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe
- Në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti me te menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe do te furnizohen me beton me cilësi të larte dhe të sigurt.

Në rast sipas përfundimit, Baza për prodhimin e betonit nga kompania “Toni Compani” SH.P.K., mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, baza për prodhimin e betonit konsiderohet krejtësisht të pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik.

- Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit e bazës për prodhimin e betonit, vendodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin lokal janë minimale dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastruktura (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit “Toni Compani”SH.P.K.

13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

TABELA E KOST – BENEFITIT TË INVESTIMIT NË BAZEN E BETONIT NGA KOMPANIA “Toni Compani” SH.P.K

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Bunkerët pranues të rërës dhe zhavorrit (5 copë)	10,000.00 €
2.	Dozatorët Pneumatik	8,000.00 €
3.	Peshoret automatike për matjen e materialit guror dhe për çimento,	6,500.00 €
4.	Peshoret automatike për matjen e materialit guror dhe për çimento	9,000.00 €
5.	Pompat dhe furnizimi me ujë	3.000.00 €
6.	Shiritat transportues furnizues	8,000.00 €
7.	Perziresit e betonit – mikseret 2 copë	12,000.00 €
8.	Silaset e çimentos me filtraventilues – 3 copë	30,000.00 €
9.	Transportuesit me Vidhë	6,000.00 €
10.	Kabina Komanduese	5,000.00 €
Shuma totale investive		97,500.00 €

“Toni Compani” SH.P.K.

14. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- [Microsoft Word - Ferizaj PZHU Lek.1 22.12. 2008](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP](#)
- [Ferizaj to 42.3917364, 21.1605529 - Google Maps](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)